



AGJENCIA KOMBETARE E BURIMEVE NATYRORE (AKBN)



BILANCI KOMBETAR ENERGETIK 2012

Tirane 2013

BILANCI ENERGETIK 2012

Permbatja

| | |
|--|----------|
| Permbatja | 2 |
| HYRJE | 3 |
| 1. ZHVILLIMET MAKROEKONOMIKE | 4 |
| 1.1. Prodhimi i brendshëm bruto dhe kërkesa agregate | 6 |
| 1.2. Prodhimi sipas sektorëve..... | 7 |
| 2. INTENSITETI ENERGETIK DHE KONSUMI I ENERJISE PER BANORE | 11 |
| 3. NDERTIMI I BILANCIT DHE SIGURIMI I INFORMACIONEVE | 12 |
| 4. FORMATI I BILANCIT ENERGETIK | 14 |
| 5. STRUKTURA E BURIMEVE ENERGETIKE NE BILANCIN ENERGETIK | 15 |
| 5.1 Burimet dhe konsumi energjetik | 15 |
| 5.2 Veteplothesimi i nevojave me burime energjetike | 17 |
| 6. ANALIZA E SIGURIMIT TE BURIMEVE ENERGETIKE | 18 |
| 6.1 Furnizimi me nafte dhe nenproduktet e naftes | 18 |
| 6.2. Nxjerrja e gazit | 20 |
| 6.3 Sektori i rafinimit | 21 |
| 6.4 Çmimet e naftes bruto dhe nenprodukteve te saj | 21 |
| 7. ENERJIA ELEKTRIKE | 22 |
| 7.1 Prodhimi i energjisë elektrike | 22 |
| 7.2. Prodhimi i Energjisë Elektrike nga TEC-i i Vlorës..... | 24 |
| 7.3. Prodhimi nga H/C Private/Koncesion të Energjisë Elektrike | 24 |
| 7.4 Importi i energjise elektrike | 25 |
| 7.5 Humbjet e energjise elektrike | 27 |
| 7.6 Tarifat e Energjise Elektrike | 28 |
| 7.7 Humbjet nga Transformimi dhe eficaenca e sistemit energjetik shqiptar | 30 |
| 8. QYMYRI..... | 30 |
| 9. DRUTE E ZJARRIT..... | 30 |
| 10. KONSUMI I BURIMEVE ENERGETIKE NE INDUSTRIRE NXJERESE DHE PERPUNUESE TE NAFTES | 31 |
| 11. KONSUMI I BURIMEVE ENERGETIKE | 31 |
| 13. ANALIZA E BURIMEVE ENERGETIKE NE KONSUMIN FINAL SIPAS DEGEVE | 33 |
| 13.1 Produktet e naftes..... | 33 |
| 13.2 Konsumi i Energjise Elektrike sipas degeve te ekonomise | 35 |
| 14. DRUTE E ZJARRIT DHE QYMYRI | 37 |
| 15. KONSUMI I BURIMEVE TE RINOVUESHME | 37 |

HYRJE

Bilanci energjetik eshte nje dokument qe paraqet situaten aktuale dhe rekomandon veprimet dhe ndryshimet qe duhet te ndermerren ne te ardhmen ne sektorin e energjise ne Republiken e Shqiperise. Ne te jane analizuar dhe perfshire te gjitha ndryshimet e nevojshme qe duhet te ndermerren per te rritur sigurine e furnizimit me burime energjetike, optimizimin e burimeve per mbulimin e nevojave me synim kryesor zhvillimin e qendrueshem te mbare ekonomise ne te ardhmen. Duke patur ne konsiderate se ndryshimet ne sektorin energjetik nuk ndodhin spontanisht, ristrukturimi i sistemit energjetik kerkon marrjen e masave shume te medha.

Eksperienca nga vendet e zhvilluara ka treguar se duhet te vendoset nje ekuilibër i drejte si ndermjet mekanizmave te tregut dhe nderhyrjeve te qeverise ashtu si edhe ndermjet aspekteve teknike/teknologjike, menaxhimit te energjise dhe rendesise qe duhet t'i kushtohet anes sociale.

Bilanci energjetik, duke qene ne thelb nje shprehje e nevojave kombetare, paraqet informacion qe i sherben zhvillimit te qendrueshem te mbare ekonomise kombetare dhe sherben njekohesisht edhe per mbrojtjen e mjedisit gjate te gjithë ciklit te shfrytezimit te burimeve energjetike.

Bilanci energjetik do te jete pjese e informacionit te pergjithshem te zhvillimit ekonomik te Shqiperise. Gjate hartimit te nje dokumenti te tille çeshtja me themelore eshte niveli i besueshmerise se te dhenave baze te perdorura per te gjitha analizat, llogaritjet per saktesine e percaktimin e treguesve te pergjithshem ekonomik per te ardhmen.

Problemet me te rendesishme me te cilat do te perballet ne te ardhmen zhvillimi ekonomik i vendit dhe sektori energjetik ne veçanti, jane rritja e konsumit te energjise per banore dhe mbajtja ne te njejten kohe e nje niveli relativisht me te ulet te intesitetit te energjise, te cilat kerkojne nxitjen e nje ekonomie efiçente dhe konkurruese. Intesiteti i energjise ne Shqiperi konsiderohet i larte krahasuar me vendet e rajonit. Per rrjedhoje, sektori i energjise ne Shqiperi do te vazhdoje te perballet me dy sfida te rendesishme: (i) mbajtjen e ketij intesiteti ne nivele mesatare, dhe (ii) rritjen e konsumit te energjise per banore (rritjen e komoditetit te jetes).

Ketij qellimi i sherben paraqitja e bilancit energjetik te vitit 2011 i cili paraqet ne menyre te sintetizuar, furnizimin e vendit tone me burime energjetike, te cilat jane te domosdoshme per nje zhvillim te qendrueshem te ekonomise se vendit. Gjithashtu ai paraqet lendet energjetike ne transformimin e tyre, duke nxjerre ne menyre indirekte problematiken dhe teknologjite qe sherbejne ne perpunimin e tyre, me qellim efcensen e perdorimit te energjise. Pjesa e

konsumit të bilancit ka vlere, pasi tregon se cilat lende energjetike dominojnë tregun, si shpendahen ato, cilat janë problemet e konsumit dhe si duhet të merren masat në përmirësimin e tij.

Domosdoshmeria e Bilancit Energjetik lidhet edhe me problemet dhe sfidat e mprehta energjetike me të cilat ballafaqohet vendi ynë. Shqipëria vazhdon të paraqitet një vend me një konsum energjie për banorë shumë të ulët dhe me një intensitet të lartë energjie si rezultat i teknologjive të vjetra që përdoren në shumë dege të ekonomisë si dhe paisjeve me standarte jo bashkohore që përdoren në sektorin e banesave dhe të shërbimeve. Problemet e alternativave të furnizimit me burime energjetike kanë ndikuar në nivelet e ulëta të aktivitetit ekonomik si dhe në nivele modeste të komfortit të jetesës.

Ky dokument përfaqëson një pasqyrë informacioni të gjithë hapsirës së zhvillimit të sektorit energjetik, duke filluar nga kërkesa, rezervat, opsionet e furnizimit deri edhe tek sjellja e konsumatorëve. Synimi thelbësor i bilancit është paraqitja e informacionit të sektorit energjetik duke dhënë garantimin e një furnizimi të sigurt me energji për të mbështetur zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik të vendit.

1. ZHVILLIMET MAKROEKONOMIKE

Ekonomia shqiptare u karakterizua nga një rritje relativisht e dobët ekonomike gjatë vitit 2012, si pasojë e pasigurive të larta, e kushteve të shtrënguara të financimit dhe e kërkesës së dobët agregate. Rritja ekonomike nuk ishte e mjaftueshme për të shfrytëzuar kapacitetet prodhuese të vendit, duke gjeneruar presione të dobëta inflacioniste nga ana e kërkesës. Kërkesa e dobët për punë prodhoi presione rënëse mbi pagat dhe kostot e tjera të punës, ndërkohë që pritjet e ankoruara inflacioniste penguan përcjelljen e efekteve të raundit të dytë në ecurinë e çmimeve të konsumit.

Pas nivelit të ulët të regjistruar gjatë pesë muajve të parë të vitit, inflacioni vjetor u luhat brenda intervalit 2%-4%, në reflektim edhe të cikleve lehtësuese të politikës monetare. Shtylla tjetër e politikave makroekonomike, ajo fiskale, shfaqti një natyrë konsoliduese, të shprehur në tkurrjen e deficitit buxhetor dhe në reduktimin e stimulit fiskal. Pozicioni i jashtëm i ekonomisë u përmirësua, duke u karakterizuar nga ngushtimi i deficitit të llogarisë korente dhe rritja e flukseve hyrës të kapitalit në formën e investimeve të huaja direkte.

Tablela 1 Disa tregues të ekonomisë në vite.

| | 2008 | 2009 | 2010 | 2011 | 2012 |
|---|-----------|-----------|-----------|-------|--------|
| Inflacioni (vit mbi vit, mesatare periudhe) | | | | | |
| Inflacioni bazë (në %) | 2.8 | 1.4 | 1.7 | 3.0 | 1.5 |
| Inflacioni total (në %) | 3.4 | 2.3 | 3.6 | 3.5 | 2.0 |
| Rritja ekonomike | | | | | |
| Rritja reale e PBB-së (në %) | 7.5 | 3.3 | 3.81 | 3.0 | 1.62 |
| PBB (me çmime korente, në milionë lekë) | 1,089,293 | 1,148,082 | 1,222,462 | NA | NA |
| Tregu i punës | | | | | |
| Numri i të punësuarve (në mijë) | 974.1 | 899.3 | 916.9 | 928.0 | 922.52 |
| Norma e papunësisë | 12.7 | 13.7 | 13.5 | 13.3 | 13.32 |

Tabela:2. Tregueset kryesor makroekonomike

| Treguesit kryesorë makroekonomik | | | | | | | | | | |
|---|--------------|---------|---------|---------|----------|----------|----------|----------|----------|----------|
| Treguesit | Njësia | 2008 | 2009 | 2010 | 2011 | 2012 | 2013 | 2014 | 2015 | 2016 |
| | | | | | | Vler. | Para. | Para. | Para. | Para. |
| Popullsia | Milion | 2.90 | 2.88 | 2.86 | 2.83 | 2.83 | 2.83 | 2.83 | 2.83 | 2.84 |
| Norma e inflacionit (mesazër) | % | 3.4 | 2.3 | 3.6 | 3.5 | 2.0 | 3.0 | 3.0 | 3.0 | 3.0 |
| Deflatori i PBB | % | 4.7 | 2.0 | 2.6 | 3.0 | 2.2 | 1.4 | 0.5 | 0.5 | 0.5 |
| Kursi i këmbimit (mesazër) | Lek / USD | 83.9 | 95.0 | 103.9 | 100.9 | 108.3 | 109.5 | 109.7 | 109.0 | 108.0 |
| Kursi i këmbimit (mesazër) | Lek / Euro | 122.8 | 131.6 | 137.7 | 140.5 | 139.0 | 139.9 | 139.5 | 140.0 | 140.4 |
| Faktori i Konvertimit sipas Paritetit të Fuqisë Blerese (PPP) | Lek / USD | 41.8 | 41.7 | 44.5 | 45.5 | 45.5 | 45.5 | | | |
| Rritja reale e PBB | % | 7.5 | 3.3 | 3.8 | 3.1 | 1.5 | 3.1 | 3.9 | 4.1 | 4.2 |
| PBB | Lek miliardë | 1,089.3 | 1,148.1 | 1,222.5 | 1,297.7 | 1,346.2 | 1,407.0 | 1,469.2 | 1,537.1 | 1,509.6 |
| PBB | USD miliardë | 13.0 | 12.1 | 11.8 | 12.9 | 12.3 | 12.8 | 13.4 | 14.1 | 14.9 |
| PBB | Euro miliard | 8.9 | 8.7 | 8.9 | 9.2 | 9.7 | 10.1 | 10.5 | 11.0 | 11.5 |
| PBB për banor | Lek mijë | 375.2 | 398.7 | 428.1 | 458.3 | 475.4 | 496.9 | 518.8 | 542.8 | 566.2 |
| PBB për banor | USD | 4,472.8 | 4,197.8 | 4,119.2 | 4,541.8 | 4,329.6 | 4,537.7 | 4,729.6 | 4,979.9 | 5,242.3 |
| PBB për banor | Euro | 3,056.5 | 3,030.1 | 3,109.1 | 3,261.4 | 3,415.1 | 3,551.6 | 3,719.2 | 3,877.2 | 4,032.5 |
| PBB për banor | USD-PPP | 8,974.1 | 9,550.8 | 9,828.6 | 10,081.6 | 10,458.0 | 10,930.7 | 11,413.8 | 11,941.2 | 12,455.1 |
| Norma e papunësisë | % | 12.7 | 13.8 | 13.5 | 13.3 | 13.4 | 13.2 | 12.9 | 12.3 | 12.0 |
| Të ardhurat totale | % e PBB | 26.7 | 26.0 | 26.6 | 25.5 | 24.7 | 25.6 | 25.6 | 25.4 | 25.7 |
| Shpenzimet totale | % e PBB | 32.3 | 33.1 | 29.7 | 29.0 | 28.4 | 29.1 | 28.0 | 27.6 | 27.7 |
| Bilanci i përgjithshëm fiskal | % e PBB | -5.5 | -7.0 | -3.1 | -3.5 | -3.7 | -3.5 | -2.4 | -2.2 | -2.0 |
| Bilanci primar fiskal | % e PBB | -2.7 | -3.9 | 0.3 | -0.4 | -0.5 | 0.1 | 1.2 | 1.4 | 1.6 |
| Bilanci korrent fiskal | % e PBB | 3.1 | 1.3 | 2.4 | 1.9 | 1.1 | 1.6 | 1.5 | 1.2 | 1.6 |
| Huamënjë totale neto | % e PBB | 4.9 | 4.6 | 3.1 | 3.5 | 3.6 | 3.4 | 2.4 | 2.2 | 2.0 |
| Borxhi Publik Total | % e PBB | 54.7 | 59.4 | 58.5 | 59.5 | 61.9 | 63.8 | 63.8 | 63.4 | 62.3 |
| Borxhi publik i qeverisë së përgjithshme | % e PBB | 51.3 | 55.5 | 54.8 | 55.8 | 57.4 | 58.4 | 58.3 | 57.9 | 57.3 |
| Borxhi publik jashtë treguesve fiskele | % e PBB | 3.4 | 4.0 | 3.7 | 3.7 | 4.5 | 5.5 | 5.5 | 5.5 | 5.0 |
| Llogaritje korente | % e PBB | -15.6 | -15.2 | -11.5 | -12.4 | -10.9 | -10.6 | -9.4 | -8.3 | -7.7 |
| Bilanci i mallrave | % e PBB | -27.4 | -26.4 | -23.5 | -24.2 | -22.7 | -21.4 | -19.9 | -19.1 | -17.9 |
| Bilanci i shërbimeve | % e PBB | 0.8 | 2.0 | 2.6 | 1.5 | 2.7 | 2.7 | 2.6 | 3.4 | 3.2 |
| Bilanci i Pagesave | % e PBB | 2.1 | -0.3 | 2.0 | -0.3 | 1.1 | 1.7 | 2.1 | 2.0 | 2.2 |

Burimë: INSTAT, Banka e Shqipërisë, Ministria e Financave, Banka Botërore

Ekonomia shqiptare u zhvillua në një mjedis ndërkombëtar të karakterizuar nga pasiguri e lartë dhe nga tensione në tregjet financiare. Megjithatë, rritja ekonomike u mbështet kryesisht në kërkesën e huaj, ndërsa kërkesa e brendshme shënoi rritje të dobët.

Perceptimi për pasiguri të shtuar dhe kushtet ende të shtrënguara të kredithënies u materializuan në konsum dhe investime të ulëta përgjatë vitit. Kërkesa agregate u zgjerua me rreth 1.6% në terma vjetorë gjatë nëntëmujorit të parë të vitit, pothuajse duke u përgjysmuar në krahasim me normën e rritjes së të njëjtës periudhë të një viti më parë.

Veprimtaria e ulët ekonomike u reflektua në rritjen e dobët të të ardhurave buxhetore gjatë vitit. Ecuria e tyre, krahas kontrollit të deficitit buxhetor, ndikoi në realizimin në shkallë më të ulët të shpenzimeve buxhetore, kryesisht të atyre kapitale. Deficiti buxhetor vlerësohet të jetë në 3.4% të PBB-së në fund të vitit. Nga ana tjetër, pozicioni i jashtëm i ekonomisë vlerësohet i përmirësuar.

Raporti i deficitit të llogarisë korente ndaj PBB-së shënoi vlerën 9.2% për nëntëmujorin e parë të vitit. Kërkesa e ulët e brendshme dhe zëvendësimi i mallrave të huaja me ato vendase ndikuan në rënien e importeve. Ndërkohë, eksportet vijuan rritjen, megjithëse me norma më të ulta se dy vite më parë. Flukset neto në llogarinë kapitale dhe financiare mbuluan rreth 90.5% të deficitit të llogarisë korente. Stoku i rezervës valutore është i mjaftueshëm për mbulimin e 4.5 muaj importesh të mallrave dhe shërbimeve.


Përmirësimi i pozicionit të jashtëm të vendit, inflacioni i ulët dhe nën kontroll, kursi i qëndrueshëm i këmbimit, si dhe bilancet e shëndosha të sektorit real dhe financiar të ekonomisë kanë forcuar më tej stabilitetin ekonomik dhe financiar të vendit gjatë vitit 2012. Tregjet financiare janë karakterizuar nga përmirësim i situatës së likuiditetit dhe prirje rënëse të normave të interesit, duke reflektuar edhe sinjalet e politikës monetare. Zhvillimet monetare tregojnë ngadalësim të ndjeshëm të normës vjetore të rritjes së agregateve të parasë gjatë vitit.

Ky ngadalësim ka reflektuar vendosjen e kursimeve të individëve në tregun e letrave me vlerë dhe kërkesën e dobët për para nga ekonomia e brendshme.

1.1. Prodhimi i brendshëm bruto dhe kërkesa agregate

Aktiviteti ekonomik ka vijuar të zgjerohet gjatë vitit 2012, por me ritëm të ngadaltë. Prodhimi i brendshëm bruto u rrit me 1.6% gjatë nëntëmujorit të parë të vitit, në krahasim me normën 3.0% të regjistruar një vit më parë. Pas tkurrjes me 0.2% në tremujorin e parë, aktiviteti ekonomik u rrit progresivisht në 2.1% dhe 2.7% në tremujorin e dytë dhe të tretë.

Ecuria e dobët ekonomike e tremujorit të parë, ndër të tjera, reflektoi ndikimin e faktorëve të përkohshëm klimaterikë në prodhimin e sektorëve të veçantë të ekonomisë. Kontributi i kërkesës së huaj në rritjen ekonomike të këtij tremujori rezultoi negativ, por rritja graduale e kësaj kërkesë udhëhoqi rritjen e eksporteve gjatë periudhës në vazhdim.




Burimi: INSTAT dhe Banka e Shqipërisë.

Grafiku 1. PBB (ndryshime vjetore dhe mesatare rrëshqitëse, majtas); Treguesi i prirjes ekonomike, treguesi i ndjesisë ekonomike dhe norma e shfrytëzimit të kapaciteteve (djathtas).

1.2. Prodhimi sipas sektorëve

Ngadalësimi gjatë vitit 2012 u ndikua në një masë të madhe nga tkurrja e sektorit prodhues⁴, e shfaqur kryesisht në tremujorin e parë. Ky sektor kontribuoi negativisht në rritjen vjetore të PBB-së, me 1.0 pikë përqindje, në dallim nga një vit më parë ku llogaritet të ketë dhënë kontribut pozitiv prej 1.2 pikësh përqindjeje. Nga ana tjetër, aktiviteti në sektorin e shërbimeve⁵ rezultoi më i përshpejtuar, dhe ka vijuar të mbështesë rritjen ekonomike. Zgjerimi vjetor i vlerës së shtuar nga sektori i shërbimeve u përkthye në kontributin prej 2.6 pikësh përqindjeje për rritjen e ekonomisë, kundrejt 1.7 pikë përqindje të gjeneruar gjatë të njëjtës periudhë të vitit të mëparshëm.




Grafiku 2. Kontributet e sektorëve në PBB-në me çmime bazë* (majtas), ecuria vjetore e saj dhe treguesi i ndjesisë ekonomike (djathtas).

Kontributet e sektorëve në ecurinë vjetore të PBB-së janë llogaritur si mesatare e kontributeve përkatës për tre tremujorët e secilit vit, për një analizë krahasuese më të saktë të zhvillimeve gjatë vitit 2012. Kontributet e degëve përkatëse në sektorin e industrisë dhe të shërbimeve përfaqësojnë gjithashtu mesatare të kontributeve për tre tremujorët e secilit vit.

Burimi: INSTAT dhe Banka e Shqipërisë.


Vlera e shtuar nga sektori i industrisë në tre tremujorët e parë të vitit regjistroi rënie me 1.4%, të përcaktuar nga dinamika e shfaqur gjatë tremujorit të parë. Performanca negative e degëve të industrisë përpunuese dhe energjisë elektrike, gazit e ujit ndikuan në tkurrjen e vlerës së shtuar totale të sektorit të industrisë me përkatësisht 4.6 dhe 0.4 pikë përqindje gjatë periudhës në analizë.



Burimi: INSTAT dhe Banka e Shqipërisë dhe llogaritje të saj.

Grafiku:3. Kontributet e degëve në ecurinë e vlerës së shtuar (majtas) dhe treguesit e vrojtimeve në sektorin e industrisë (djathtas).

Grafiku:4. Ecuria e vlerës së shtuar (majtas) dhe e treguesve të vrojtimeve (djathtas) në sektorin e ndërtimit.




Burimi: INSTAT dhe Banka e Shqipërisë dhe llogaritje të saj.

Ngadalësimi i ritmit vjetor të rritjes së eksporteve industriale⁷ në tremujorin e katërt të vitit 2012 sinjalizon zgjerim më të ngadaltë të aktivitetit në industrinë nxjerrëse dhe përpunuese për

këtë tremujor. Gjithashtu, rritja me ritme më të ulëta vjetore e prodhimit të energjisë elektrike në fundin e vitit pritet të ndikojë në ngadalësimin e ecurisë së degës “Energji elektrike, gaz dhe ujë”. Ndërkohë, bazuar në të dhënat e vrojtimeve 8, bizneset vlerësojnë aktivitet lehtësisht të përmirësuar në sektorin e industrisë në tremujorin e katërt.

Prodhimi në sektorin e ndërtimit rezultoi i tkurrur gjatë vitit 2012. Vlera e shtuar në ndërtim shënoi rënie vjetore me 16.9% në tre tremujorët e parë të vitit 2012, duke u përkthyer në një kontribut negativ rreth 2.0 pikësh përqindjeje për rritjen e PBB-së. Bazuar në statistikat e lejeve të ndërtimit, rezulton se investimet në ndërtesa banimi kanë rënë ndjeshëm dhe në të njëjtën kohë sugjerohen zhvillime të dobëta në periudhat e ardhshme. Gjithashtu, sektori publik ka ulur kontributin¹¹ e tij në aktivitetin ndërtues gjatë vitit. Aktivitetet e bujqësisë, gjuetisë, pyjeve dhe peshkimit regjistruan ritme pozitive rritjeje vjetore gjatë tre tremujorëve të parë të vitit. Gjatë kësaj periudhe, rritja e vlerës së shtuar të prodhuar nga ky sektor u luhat rreth normës vjetore prej 5.5%. Kjo normë qëndron mbi mesataren historike të zgjerimit prej 3.8%.

Performanca pozitive e sektorit të bujqësisë zgjeroi me 1.1 pikë përqindjerritjen vjetore të PBB-së për tre tremujorët e parë të vitit.



Burimi: INSTAT dhe Banka e Shqipërisë dhe llogaritje të saj.

Grafiku:5. Kontributet e degëve në ecurinë e vlerës së shtuar (majtas) dhe treguesit e vrojtimeve në sektorin e shërbimeve (djathtas).

Norma mesatare vjetore e rritjes së vlerës së shtuar në sektorin e shërbimeve rezultoi rreth 5.0% gjatë tre tremujorëve të parë të vitit¹². Ecuria e aktiviteteve të shërbimeve shfaqet e përmirësuar në krahasim me zgjerimin prej 3.3% të shënuar në të njëjtën periudhë një vit më parë. Zhvillimet në degët e “Shërbimeve të tjera”¹³, “Tregtisë” dhe “Postës e komunikacionit” favorizuan rritjen vjetore të vlerës së shtuar, me përkatësisht 3.7, 1.8 dhe 0.9 pikë përqindje.

Ndërkohë, tkurrja e aktivitetit në degët e “Transportit” dhe “Hoteleve e restoranteve” llogaritet të ketë kontribuar negativisht në zgjerimin e vlerës së shtuar me 1.1 dhe 0.3 pikë përqindje. Rritja me 8.4% e vlerës së shtuar në aktivitetet e lidhura me shërbimet e tjera u ndikua kryesisht nga ecuria e nëndegës “Pasuri të paluajtshme, dhënie me qira dhe shërbime kundrejt bizneseve”. Gjithashtu, dega e “Postës dhe komunikacionit” dalloi për zgjerimin me ritme të përshpejtuara të vlerës së shtuar, të përcaktuar gjerësisht nga zhvillimet në shërbimet e komunikacionit.

2. INTENSITETI ENERGJETIK DHE KONSUMI I ENERGJISE PER BANORE

Shqipëria paraqitet me një konsum energjie shumë të ulët për banorë. Në një shkallë të madhe kjo zbulon nivelet e ulta të aktivitetit ekonomik si dhe nivelet modeste të komfortit që krijohen në sektorin e popullatës dhe në ato të shërbimeve. Kështu, një nga çështjet më të rëndësishme për zhvillimin e ardhshëm të ekonomisë shqiptare dhe sektorit të saj të energjisë është se si mund të barazohet presioni i vazhdueshëm për të rritur konsumin e energjisë për banorë me nevojën, për të reduktuar intensitetin e lartë të energjisë, për të pasur një ekonomi efikente e cila me tej të konkurojë si në tregun e brendshëm me mallrat e importit ashtu edhe në tregun e jashtëm, për të bërë të mundur ekzistencën e tregjeve të eksportit për kategori të caktuara mallrash dhe produktesh.


Konsumi energjetik për banorë është një tregues tjetër që shpreh mirëqenien, mënyrën e jetesës por nga ana tjetër dhe sjelljen apo qëndrimin e konsumatorëve përkundrejt konsumit të burimeve energjetike.

Treguesi i konsumit të energjisë për frymë të popullsisë për vitin 2012 rezultoi 0.604 toe/banor, ndërsa për vitin 2011 rezultoi në nivelin e 0.602 toe/banorë. Për vitin 2010 konsumi energjetik për banorë është vlerësuar në vlerën e 0.591 toe/ banorë.

Intensiteti energjetik është një tregues sintetik shumë i rëndësishëm, që tregon nivelin e zhvillimit të sektorit energjetik, sidomos në drejtim të efikasitetit të energjisë. Ai shpreh raportin e konsumit të burimeve primare energjetike në një vit të caktuar me PBB-në të prodhuar po në atë vit. Historikisht, intensiteti i energjisë në Shqipëri ka qenë shumë i lartë. Kjo do të thotë se prodhimi makro ekonomik, i raportuar normalisht nga PBB-ja ka qenë i ulët, krahasuar me konsumin e

pergjithshem te energjise. Arsyet jane te njejta si dhe per vendet e tjera te Europes Qendrore dhe Lindore: industria shqiptare ka qene e orientuar drejt industrive intensive me konsum te larte te energjise si minierat dhe metalurgjia, ku çmimet e ulta te energjise kane mbizotuar gjate gjithe kohes.

Intensiteti energjetik per vitin 2012 rezulton te jete ne nivelin 0.345 toe/000Euro. Ky intensitet rezulton me nje permiresim te tij qe e ka bazen ne konsumin e burimeve energjetike perkundrejt nje PBB-je me te larte se ajo e vitit 2011. (PBB-ja ka qene 9.7 miliard Euro ne vitin 2012). Intensiteti energjetik per vitin 2011 ka qene ne nivelin e 0.358toe/000Euro. Zvogelimi i Intesitetit Energjetik lidhet me perdorimin efektiv te energjise ne shkalle vendi.



Grafiku 6: Intensiteti Energjetik dhe Konsumi / banore. Vitet 2007-2012

3. NDERTIMI I BILANCIT DHE SIGURIMI I INFORMACIONEVE

Bilanci i vitit 2012 eshte ndertuar me metodiken e vleresimit si nga lart-poshte dhe nga poshte larte per te duke patur nje vlere mosperputhje 7.8% qe do te thote nje shifer te pranueshme per vendet ne zhvillim siç eshte Shqiperia. Bilancet ndjek nje ecuri si te viteve 2000-2012 kjo bazuar ne eksperiencat dhe rekomandimet e institucioneve nderkombetare me te cilat bashkepunohet vazhdimisht.

Analiza e verifikimit kryhet per te gjetur shifrat sa me te sakta te konsumit final te energjise dhe pse raportimet per furnizimin me lende energjetike, kryesisht produkte nafte dhe dru zjarri nuk i pergjigjen konsumit real te konsumatoreve. Kjo diference ndodh, per drute e zjarrit nga mungesa e statistikave te organeve pergjegjese qe e menaxhojne kete lende energjetike, ndersa produktet e naftes kryesisht karburante nga lëvizja e lire kufitare dhe informaliteti.

Theksojme se metodologjia kontrollit te bilancit nga poshte-lart perdoret jo vetem ne vendet e rajonit tone por edhe ne vendet e zhvilluara per te kontrolluar sasite e flukseve te lëvizjes se produkteve te naftes. Kjo metodologji llogaritjeje eshte mjaft e rendesisheme per vendin tone duke patur ne konsiderate hapjen e kufijve dhe mundesine e futjes te lendeve hidrokarbure (karburante per automjete) nga vendet fqinje si pasoje e rritjes se fluksit te automjeteve qe hyjne dhe dalin ne pikat kufitare.

Hartimi i Bilancit Energjetik, eshte mbeshtetur ne te dhenat e mbledhura nga institucionet shteterore dhe kompanite e ndryshme, te cilat operojne ne fushen e energjise ne Shqiperi.

Institucionet dhe informacionet e siguruar nga to, jane si me poshte:

| | |
|---|---|
| <ul style="list-style-type: none">• Informacionet mbi te dhenat makroekonomike dhe popullsia jane siguruar nga: | <ul style="list-style-type: none">- Keshilli i Ministrave; Ministria e Financave |
| <ul style="list-style-type: none">• Te dhenat mbi energjine elektrike jane siguruar nga: | <ul style="list-style-type: none">- Enti Rregullator i Energjise (ERE)- Korporata Elektroenergjetike Shqiptare (KESH sh.a)- Operatori i Sistemit te Transmetimit (OST sh.a)- Operatorit i Sistemit te Spherndarjes (OSSH sh.a) |
| <ul style="list-style-type: none">• Te dhenat per hidrokarburet jane siguruar nga: | <ul style="list-style-type: none">- Ministria e Ekonomise, Tregtise dhe Energjetikes (METE)- Raporti vjetor i shoqerise Albpetrol sh.a Viti 2009;- Raporti vjetor i shoqerise ARMO sh.a Viti 2010;- Drejtoria e Pergjithshme e Doganave; |
| <ul style="list-style-type: none">• Te dhenat per drute e zjarrit jane siguruar nga: | <ul style="list-style-type: none">- Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit te Ujerave;- Investigime nga AKBN-ja |
| <ul style="list-style-type: none">• Te dhena per sektorin e transportit jane siguruar nga: | <ul style="list-style-type: none">- Ministria e Puneve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit |

| | |
|--|---|
| | - Investigimi nga AKBN-ja |
| • Te dhenat per sektorin e bujqesise jane siguruar nga: | - Ministria e Bujqesise, Ushqimit dhe e Mbrotjes se Konsumatorit - Investigimi nga AKBN-ja |
| • Te dhenat per sektorin e industrise jane siguruar nga: | Qendra e Kombetare e Regjistrimit |

4. FORMATI I BILANCIT ENERGJETIK

Bazuar ne Vendimin e Keshillit te Ministrave Nr. 202, date 11.04.2007, "Per disa shtesa dhe ndryshime ne Vendimin e Keshillit te Ministrave Nr. 547, date 9.8.2006, "Per krijimin e Agjencise Kombetare te Burimeve Natyrore", Agjencia Kombetare e Burimeve Natyrore, ka detyrim te pergatise Bilancin Energjetik ne perputhje me formatin EUROSTAT/IAE.

Nga Instituti i Statistikave te Shqiperise (INSTAT), Ministrite, Korporata Elektroenergjitike Shqiptare (KESH), Operatori i Sistemit te Shperndarjes (OSSH), Enti Rregullator i Energjise (ERE) etj, sigurohen te dhena ne lidhje me ekonomine e Shqiperise, te dhena makroekonomike, çmimet, konsumi i elektricitetit, te dhena mbi popullsine, ndertesat, etj.

Vlen per t'u shenuar fakti, se ka te dhena mbi Sektorin e Banesave, ne lidhje me ndertesat bazuar ne kategorite e ndryshme te tyre, si dhe disa te dhena te dobishme mbi sektorin e ndertimit publik.

Gjithashtu, ka te dhenat per sektorin e transportit, lidhur me numrin e automjeteve, kamioneve, autobuzeve dhe furgonave dhe te dhenat te tjera. Bazuar ne Censusin, te publikuar nga INSTAT, jane siguruar te dhena mbi numrin e banesave, mesataren e personave per banese, te ardhurat e tyre, punesimin ne sektoret publik dhe privat, bizneset ne te gjithe vendin (ndermarrjet), etj.

Agjencia Kombetare e Burimeve Natyrore dhe Ministria e Ekonomise Tregtise dhe Energjitikes (METE) kane se bashku detyren e mbledhjes dhe perpunimit te te dhenave, formulimit te pasqyrave dhe treguesve te energjise, analizimit dhe shperndarjes se informacionit.

Per hartimin e Bilancit Energjetik, te dhenat e mbledhura perpunohen dhe analizohen, duke i pershtatur me kerkesat e formatit te Eurostatit per Bilancin Energjetik.

Duhet theksuar se Bilanci i Energjise percaktohet ne perputhje me metodologjine EUROSTAT, vetem ne pasqyren agregate dhe jo ashtu si ajo duhet te jete ne detaje, kjo per arsye se per te dhenat e konsumit te energjise ne deget e ndryshme te energjise, eshte ende e nevojshme te nxirren te dhena me te detajuara.

Veshtiresi ndeshen edhe ne procesin e vleresimit te humbjeve pergjate proceseve te transformimit nga burimet primare te energjise ne burime sekondare, siç jane produktet e naftes, energjia e marre nga djegia e qymyreve per qellime energjetike, energjia elektrike e perftuar nga TEC-et.

Ashtu siç eshte permendur edhe me lart, ende nuk ka te dhena te detajuara dhe te mjaftueshme per sa i perket kerkeses; si rrjedhim eshte e nevojshme te permiresohen statistikat mbi energjine, si per anen e furnizimit ashtu edhe per ate te kerkeses, kjo edhe ne kuader te Komunitetit te Energjise ku Shqiperia dhe te gjithë vendet e rajonit brenda ne vitin 2012 hartojne bilancin energjetik plotesisht sipas kerkesave te EUROSTAT-it. Per kete arsye kerkohet qe Agjencia Kombetare e Burimeve Natyrore te mbeshtet me nje kuader me te plote ligjor, per te mundesuar sigurimin e te gjitha te dhenave me te nevojshme, te kerkuara prej saj.

5. STRUKTURA E BURIMEVE ENERGETIKE NE BILANCIN ENERGETIK

5.1 Burimet dhe konsumi energjetik


Nga një vështrim i përgjithshëm i furnizimit gjithsej me burime energjetike primare, nga viti 2003 e deri në ditët e sotme, vërejmë se furnizimi për të gjithë sektorët ka pësuar një rritje nga viti në vit. Per t'i paraprire rritjes se kerkeses per konsum te lendeve energjetike jane zhvilluar mjaft projekte ne fushen e energjise, si per rritjen e prodhimit te burimeve primare ne vend ashtu dhe per krijimin e nje infrastrukture energjetike interkonjeksioni ne menyre qe vendi yne te integrohet ne rrjetat Europiane te energjise per te marre pjese ne tregun kompetitiv te energjise elektrike dhe gazit natyror.

Burimet energjetike qe dominojne dhe kane mbajtur peshen kryesore ne Bilancin Energjetik jane: nafta dhe nen produktet e saj, hidroenergjia, drute e zjarrit, qymyri, gazi natyror dhe pak produkte dytesore te cilat vijne si rrjedhoje e shfrytezimit te energjise diellore dhe nxehtesise se perftuar nga proceset termike.

Tabela 3. Burimet Energjetike 2012, Burimi: AKBN


| Burimet Energjetike | % | ktoe |
|---------------------|--------|---------|
| Qymyri | 4.15% | 83.41 |
| Gazi | 0.73% | 14.66 |
| Nafta dhe produktet | 53.17% | 1068.45 |
| Drute e zjarrit | 10.28% | 206.50 |
| En.djellore | 0.59% | 11.80 |
| Hydro | 31.08% | 624.62 |

Per vitin 2012, Totali i Produkteve Primare Energjetike (TPPE) ka rezultuar ne 2014.15 Ktoe, me nje ulje prej 147.64 ktoe, krahasuar me vitin 2011 si pasoje e furnizimit te ulet me produkte te naftes. Në furnizimin sipas burimeve, për vitin 2012 vlen të përmendet që hidrokarburet kanë kontribuar me 1068.45 ktoe, ose 53.17% përkundrejt totalit, energjia elektrike me 624.62ktoe, ose 31.08%, drutë e zjarrit me 206.50 ktoe, ose 10.28%, vlen te permendim rritjen e perdorimit te qymyrit me 4.15% ose 83.41 ktoe dhe pjesa tjetër përbëhet nga burime të tilla si gazi natyror dhe energjia e përftuar nga panelet diellore.



Grafiku 7: Burimet Primare Energjetike per vitin 2012. [%] Burimi: AKBN

Pavarësisht se situata e furnizimit me produkte primare energjetike vjen gjithmonë në rritje, tregu i vendit tonë kërkon përmirësime në sigurinë e furnizimit me energji. Ne Grafikon 7 jepet kontributi i produkteve primare.




Grafiku 8: Ecuria ne vite e burimeve energjetike 2005-2012 [ktoe]Burimi: AKBN

Vlen te permendim qe per vitin 2012 prodhimi i naftes brut ka nje maksimum krahasuar me vitet e tjera duke aritur vleren 1030.723 ktoe. Importet per vitin 2012 kapin vleren 68.2 %, ku kontributin kryesor e kane lendet energjetike me baze hidrokarbure dhe energjia elektrike dhe qymyret kjo e fundit eshte ritur sipasojë e perdorimit nga sektori i industria. Eksportet kapin vleren 36 %. Ne Grafikon 8 eshte paraqitur ecuria ne vite e Totalit te Produkteve Primare Energjetike (2005-2012) e shprehur ne ktoe.

5.2 Veteplothesimi i nevojave me burime energjetike

Ne vitin 2012, krahasuar me vitin 2011, vihet re nje ulje e lehte e veteplothesimit te nevojave me burime energjetike, kjo si pasojë e prodhimit te ulet te energjise elektrike si dhe exportit te larte te naftes brut. Raporti i plotesimit te nevojave energjetike me produkte vendi per vitin 2012 ishte 31.8% dhe pati nje rritje krahasuar me vitin 2011 gati me 1.8 % e cila ka ardhur si rrjedhojë e rritjes se eksportit te naftes brut, nga 697 ktoe per vitin 2011 ne 957 ktoe per vitin 2012, ndersa prodhimi i energjise elektrike u rit krahasuar me vitin 2011 nga 357.59 ktoe ne 406.35 ktoe ne vitin 2011. Prodhimin vendas te hidrokarbureve ka nje rritje nga 894.53 Ktoe ne vitin 2011 ne 1030.723 ktoe ne vitin 2012. Grafiku 9 paraqet ecurine e veteplothesimit te nevojave tona me burime energjetike.



Grafiku 9: Vetepletesimi me burime energjetike 2012 [%]

6. ANALIZA E SIGURIMIT TE BURIMEVE ENERGETIKE

6.1 Furnizimi me nafte dhe nenproduktet e naftes


Furnizimi i ekonomisë me nënprodukte nafte dhe gazi realizohet nga importi dhe prodhimi vendas. Megjithëse prodhimi vendas i nënprodukteve të naftës dhe gazit plotëson rreth 12.5 % të nevojave të ekonomisë, kjo për shkak të mospërpunimit të gjithë sasisë së naftës bruto të prodhuar në vend. Produktet e naftës të përpunuara në vend luajnë rol në tregun e vendit për konsumatorët industrial dhe të shërbimeve. (Grafiku 6). Niveli i prodhimit të naftës bruto në total (Albpetrol, Bankers Petroleum Albania Ltd dhe Stream Oil & Gas) për vitin 2012 arriti në 1 030 723 toe, i cili është niveli më i lartë në 15 vitet e fundit.

Duhet theksuar se për një shfrytëzim më të mirë të vendburimeve tona të naftës, për rritjen e koeficientit të naftënxjerrjes nëpërmjet përdorimit të teknologjive të ndryshme, si dhe për kërkimin dhe zbulimin e vendburimeve të reja, janë nënshkruar dhe miratuar marrëveshje hidrokarbure me disa kompani të huaja të tilla si Bankers Petroleum Albania Ltd, Steam Oil & Gas, Sharewood International Ltd dhe IEC Visoka Inc. në vendburimet ekzistuese dhe Island International Exploration BV, Medoil dhe DWM Petroleum AG, si dhe Petromanas Albania GmbH, Island International Ltd; Capricorn, Bankers Petroleum Albania Ltd. në blloqet e reja të kërkimit.

Sektori i rafinimit të naftës bruto përballet me vështirësi, si pasojë e teknologjisë së vjetër, si dhe mungesës së një sistemi modern për operacionet e punës dhe mirëmbajtjes së sistemit të

kontrollit. Ai ka pasur probleme serioze në kontrollin e ndotjeve mjedisore, të cilat dora dorës, për shkak të investimeve të realizuar në këtë sektor, ka pësuar përmirësime. Pas privatizimit të ARMO Sh.A të 85% të aksioneve, ka patur përpjekje në drejtim të cilësisë të prodhimit të nënprodukteve, duke përmendur këtu Gazoilin, ndërkohë, që duhet të vazhdohet në drejtim të rritjes së cilësisë së nënprodukteve të tjera, për të qënë konkurruese në tregun vendas dhe atë rajonal, por edhe për të mundësuar rritjen e kapaciteteve përpunuese të naftës bruto në vend, duke realizuar kështu një rritje të vlerës së këtij burimi natyror strategjik me të cilën është e pasur nëntoka Shqiptare.

Sektori i përpunimit të naftës është i privatizuar dhe përfaqësohet nga shoqëria ARMO sh.a, ku shteti ka 15 % të aksioneve. Në zhvillimet strategjike të sektorit të energjisë opioni për ndërtimin e një rafinerie të re është marrë në konsideratë.



Grafiku 10: Ecuria e prodhimit vendas të naftës bruto sipas vendburimeve dhe e konsumit [ktoe] Burimi: AKBN

Infrastruktura bregdetare e import-eksportit dhe depozitimit të naftës, gazit dhe nënprodukteve është modernizuar dhe operohet në dy terminale bregdetare, atë të Vlorës (Porti Vlorë-1) dhe të Porto-Romanos, Durrës, (Porti "Porto Romano"), të cilat kanë kapacitete të konsiderueshme përpunimi dhe depozitimi, si dhe janë ndërtuar në përputhje me standartet e sigurisë dhe mbrojtjes së mjedisit.

Shpërndarja gjeografike e impianteve, magazinave dhe stacioneve të shitjes me shumicë dhe shoqërive të tregtimit me pakicë, është në të gjithë territorin e Shqipërisë. Ato garantojnë një furnizim normal të konsumatorëve në mbarë vendin. Rezerva e sigurisë ka ardhur duke u rritur

nga viti në vit. Për vitin 2007, ajo ka qenë 41 684 ton, për vitin 2008 ka qenë në nivelin e 102 985 ton dhe në vitin 2012 ajo është 187 886 ton. Megjithatë, në kuptimin e menaxhimit të rezervës së sigurisë ka nevojë për një rishikim të skemës së sigurisë së rezervës dhe të subjekteve që duhet ta sigurojnë atë, kjo në përputhje edhe me rekomandimet e Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë. Për këtë qëllim është parashikuar të bëhet një studim i thelluar për rezervën e sigurisë, mënyrën e përcaktimit dhe menaxhimit të saj, si dhe institucionet që duhet ta menaxhojnë këtë rezervë.

Importi i produkteve të naftes dhe i naftes bruto per vitin 2012 arrin vleren 977.32 ktoe duke patur nje ulje me 127.88 ktoe krahasuar me vitin 2011. Kjo ulje ka ardhur si pasoje e uljes se konsumit te produkteve te naftes ne sektorin e transportit si pasoje e krizes ekonomike. Eksporti i naftes dhe i produkteve te saj per vitin 2012 arriti 957.09 ktoe duke pesuar nje rritje 28 % ktoe krahasuar me vitin 2011. Rritja ne vitin 2011 ka ardhur si pasoje e shtimit te sasise se eksportit te naftes brut nga kompania Bankers dhe sasite e larta te produkteve te eksportuara nga kompania ARMO te tilla si benzine verxhine, koks, solar dhe bitum.

6.2. Nxjerrja e gazit

Aktualisht, vendi ynë ka një prodhim minimal gazi natyror, rreth 17 Milion Nm³, sasi gati e papërfillshme dhe që shërben vetëm për furnizimin e rafinerive dhe proceseve teknologjike të industrisë së naftës. Pavarësisht nga angazhimet e srtukturave te shtetit dhe nxitjes se investitorëve të huaj, vendi ynë nuk është lidhur me rrjetin ndërkombëtar të gazit. Është e kuptueshme se lidhja e Shqipërisë me rrjetin e gazit do të ketë një ndikim pozitiv në përmirësimin e situatës energjetike në vend, duke ndikuar në mënyrë të ndjeshme në raportet e përdorimit të energjive ku deri më sot ngarkesa kryesore i takon nënprodukteve të naftës dhe energjisë elektrike.

Gazi i lëngët i naftës (GLN) në vendin tonë ka rritur në mënyrë të ndjeshme prezencën dhe po luan një rol gjithmonë e më të madh në tregun vendas si burimi energjetik alternativ më i mundshëm për të zëvendësuar energjinë elektrike në sektorin e banesave dhe shërbimeve, duke u konsumuar kryesisht për ngrohje dhe gatim dhe duke arritur një konsum total për vitin 2012 prej 88.38 ktoe. Një përdorim gjithmonë e më të gjerë kjo lëndë energjetike po gjen në industrinë ushqimore dhe atë të ndërtimit.

Duke patur parasysh GLN-në si alternative energjitike e cila mund te zëvendësoje me shpejtësi konsumin e energjisë elektrike, politika e Qeverisë është drejtuar në zhvillimin e kapaciteteve deponuese në volume të ritura për të ulur ne kete menyre koston e transpotit. Në mbështetje dhe në zbatim të këtyre objektivave strategjike, si rezultat i investimeve të realizuara gjatë viti 2009, u futën në shfrytëzim terminallet bregdetare të naftës në Gjirin e Vlorës (Porti Vlorë-1 dhe

terminali i depozitave nga shoqëria koncesionare “La Petrolifera Italo Albaneze”sh.a.), si dhe në zonën e Porto-Romanos, Durrës, (Porti “Porto Romano” nga shoqëria koncesionare “Romano Port”sh.a.

6.3 Sektori i rafinimit

Gjate vitit 2012 Shoqëria e perpunimit dhe marketingut të naftës ARMO bleu naftë brut nga Shoqëria Albpetrol, kompania Bankers dhe nga kompania Steam Petroleum 110.65 ktoe. Në total perpunimi i naftës brut në rafinerite tona ishte 106.15 ktoe.

Humbjet teknologjike të rafinerive kanë qenë rreth 3.4%. Viti 2012 ka qenë një vit problematik për shfrytëzimin e naftës brut në rafinerinë e Ballshit dhe të Fierit. Shoqëria ARMO sh.a e privatizuar në vitin 2008 (85% e aksioneve), gjatë vitit 2012 ka pasur probleme ekonomike të cilat kanë krijuar vështirësi në funksionimin normal të punës.

Duke mbajtur në konsideratë Totalin e Produkteve Primare Energjetike (TPPE), humbjet në procesin e transformimit për hidrokarburet, rezultojnë të jenë në nivelin e 10.6% të TPPE-se.

6.4 Çmimet e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj

Nenproduktet e naftës dhe të gazit në tregun shqiptar janë të liberalizuara dhe ndjekin në mënyrë rigorozë ecurinë e çmimeve të këtyre nënprodukteve në bursat ndërkombetare duke u shtuar atyre taksat dhe tatimet sipas niveleve të përkrahura për çdo produkt, koston e transportit si dhe normën mesatare të fitimit (rreth 10%). Për vitin 2012 në çmimin e produkteve të naftës ruajti të njëjtat standarte si gjatë vitit 2011.

Për sa i përket çmimit të naftës bruto të prodhuar në vend, pas vitit 2008, me privatizimin e shoqërisë së rafinimit ARMO sh.a., ky çmim është i lidhur në mënyrë të drejtperdrejtë me kuotimin e këtij produkti në bursën BRENT, pavarësisht nga kostojat e prodhimit të tij nga shoqëritë e kërkimit prodhimit që operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë. Mbi prodhimin e shitur të naftës bruto aplikohet një taksë prej 10%, e quajtur “Rente Minerare”, sipas dispozitave të Ligjit Nr. 9975, datë 28.7.2008 “Për taksat kombetare”, i ndryshuar.

7. ENERGJIA ELEKTRIKE

7.1 Prodhimi i energjisë elektrike

Prodhimi i energjisë elektrike në vendin tonë është i bazuar në prodhimin e saj nga burimet hidrike (më shumë se 98%), prandaj dhe besueshmëria e sistemit tonë elektroenergjetik është shumë e varur nga kushtet hidrike. Fuqia e instaluar e Sistemit Elektroenergjetik Shqiptar është rreth 1726 MW dhe prodhimi i energjisë elektrike nga burimet e vendit, duke qënë se është nga burimet hidrike, ka natyrë propabilitare, që lëviz nga rreth 3 miliard kWh/vit deri në 7,7 miliard kWh/vit, në varësi të kushteve hidrike (rreth 7,7 miliarde kWh në vitin 2010). Prodhimi mesatar vjetor, në vite hidrik normal është rreth 4.2 miliard kWh. Duke patur në konsideratë, që kërkesa për energji elektrike në vendin tonë aktualisht është 7.342 TWh/vit, dhe prodhimi vendas rreth 4.2 TWh/vit, pra është i pamjaftueshëm, bën të detyrueshëm që aktualisht, mbulimi i nevojave duhet të përballohet nëpërmjet importit të energjisë elektrike.

Nga ana tjetër, duhet të vëmë në dukje që kapacitetet importuese të vendit tonë janë të limituara. Kjo vjen si pasojë e kapaciteteve të limituara që kanë linjat tona të interkonjeksionit me vendet fqinjë, por edhe të linjave të interkonjeksionit të vendeve të rajonit, pasi vendi ynë është pikë fundore në rrjetin rajonal të energjisë elektrike.

Duhet theksuar gjithashtu, se importi i energjisë elektrike është vështirësuar edhe për shkak të rritjes së defiçitit të energjisë elektrike në rajonin e Ballkanit, ku numri më i madh i vendeve, përveç Bullgarisë, Rumanisë dhe Bosnje Hercegovinës, janë importues neto të energjisë elektrike.

Prodhimi publik i energjisë elektrike kryhet nga Shoqëria Aksionere KESH Sh.a. me zotërim 100% të aksioneve nga shteti, si dhe nga Shoqëria “TEC-Vlora”, gjithashtu me 100% të aksioneve nga shteti, e cila është pjesë e KESH sh.a.

Struktura e centraleve elektrike të prodhimit publik tregon qe fuqia e përgjithshme e instaluar arrin në 1,448 MW, nga të cilat fuqia e instaluar e HEC-ve është 1,350 MW dhe e TEC-eve 98 MW. Duke marrë parasysh edhe fuqinë e përgjithshme të instaluar të prodhuesve privatë të energjisë elektrike prej 195.8 MW, fuqia e përgjithshme e instaluar në vendin tonë rezulton 1 726 MW.

Kontributi i sektorit privat të energjisë elektrike tregon se aktualisht janë në prodhim 68 hidrocentrale nga 40 shoqëri private dhe koncensionare, me fuqi të përgjithëshme të instaluar prej 195.8 MW nga të cilat rreth 120 MW perbejne H/C qe kane filluar prodhimin gjatë vitit 2012. Prodhimi i përgjithshëm për vitin 2012 nga gjeneruesit privatë ka qënë 299.9 GWh ose 7.0 % e prodhimit të përgjithshëm neto vendas të vitit 2012.

Nga krahasimi i prodhimit të energjisë elektrike gjatë periudhës 2002 – 2012 vërehen diferenca jashtëzakonisht të mëdha. Prodhimi më i ulët vjetor gjatë kësaj periudhe është ai i vitit 2007 me 2,918 milion kWh ose me një prodhim mesatar ditor prej 7.9 milion kWh. Ndërsa prodhimi më i madh është ai i vitit 2010 me 7,743.295 milion kWh ose me një prodhim mesatar ditor prej 21.2 milion kWh. Sikurse vihet re diferenca ndërmjet këtyre dy prodhimeve ekstremale arrin në 2.7 herë. Një tregues i tillë shpreh në mënyrë sinjifikative shkallën e lartë të riskut hidrogjik në stabilitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga sistemet elektroenergjetike të mbështetur vetëm në HEC-e.


Në tabelën 4 janë paraqitur treguesit kryesorë të energjisë elektrike nga viti 2002 dhe deri në vitin 2012.

Tabela 4 Treguesit kryesorë të energjisë elektrike

| Emertimi | Viti | | | | | | | | | | |
|-----------------------------------|-------|-------|-------|-------|-------|-------|-------|------|-------|------|------|
| | 2002 | 2003 | 2004 | 2005 | 2006 | 2007 | 2008 | 2009 | 2010 | 2011 | 2012 |
| Prodhimi (GWh) | 3,204 | 4,974 | 5,467 | 5,409 | 5,516 | 2,933 | 3,770 | 5201 | 7743 | 4185 | 4725 |
| Importi (GWh) | 2,072 | 937 | 567 | 365 | 633 | 2,828 | 2,417 | 1884 | 0 | 3262 | 2538 |
| Furnizimi (GWh) | 5,430 | 5,900 | 5,945 | 5,933 | 6,121 | 5,750 | 6,300 | 6592 | 6773 | 7342 | 7617 |
| Sasia vjetore e Ujit (Miljard,m3) | 4.44 | 5.8 | 7.81 | 6.74 | 6.52 | 4.11 | 4.12 | 6.00 | 10.85 | 5.08 | 5.08 |
| Konsumi specifik (m3/kWh) | 1.38 | 1.17 | 1.43 | 1.25 | 1.18 | 1.40 | 1.04 | 1.19 | 1.20 | 1.20 | 1.20 |

Rritja mesatare vjetore e kërkesës për energji, në vleftë absolute, gjatë kësaj periudhe rezulton me 183 GWh/Vit. Në periudhën përpara vitit 2008, për shkak të ndërprerjeve të programuara, të detyruara, të energjisë ky tregues nuk është real. Duke ju referuar viteve 2009, 2010 dhe 2011, konstatojmë, se rritja e kërkesës për energji në vitin 2010 rezulton 378 GWh më shumë në vleftë absolute se në vitin 2009, ose me 6% më shumë, ndërsa në vitin 2011 me 372 GWh ose me 5% më shumë se viti 2010.

Gjatë vitit 2012 prodhimi i neto i energjisë elektrike paraqitet si me poshte.



(Burimi OST)

Grafiku:11. Prodhimi Neto i Energjise Elektrike per vitin 2012

Viti 2012 nga pikpamja hidrologjike vlerësohet si një vit, me prurje me shkallë sigurie jo te larte, gjë që nuk ka ndikuar pozitivisht në prodhimin e energjisë elektrike në vend, duke arritur nje prodhim afersisht mesatar duke u nisur nga historiku i të gjitha kohrave në Shqipëri.

7.2. Prodhimi i Energjisë Elektrike nga TEC-i i Vlorës

Gjate vitit 2012 nuk kemi prodhim nga TEC Vlora. Ky TEC ishte parashikuar të vihej në punë gjatë vitit 2011, por për shkak të problemeve teknike të konstatuara gjatë testimeve u vonua futja në punë i këtij burimi. KESH sh.a. eshte ne proces te verifikimit te problemeve teknike te evidentuara ne kushtet e mosrealizimit te detyrimeve kontraktuale.

7.3. Prodhimi nga H/C Private/Koncesion të Energjisë Elektrike

Struktura e prodhimit privat të energjisë elektrike është paraqitur në mënyrë të përmbledhur në tabelën -5-. Aktualisht janë në prodhim 68 hidrocentrale nga 40 shoqëri private dhe koncensionare, me fuqi të përgjithëshme të instaluar prej 195.8 MW nga të cilat rreth 120 MW perbejne H/C qe kane filluar prodhimin gjatë vitit 2012. Prodhimi i përgjithshëm për vitin 2012 nga gjeneruesit privatë ishte 299.9 GWh ose 7.0 % e prodhimit të përgjithshëm neto vendas të vitit 2012.

Në grafikun e figurës -11-është paraqitur ecuria e prodhimit nga HEC-et e vegjël (deri 15 MW) gjatë periudhës 2004 – 2012. Duke marrë parasysh që prodhimi i rritur i vitit 2010 përveç rritjes

së kapaciteteve të instaluara në një masë të madhe u ndikua nga kushtet shumë të favorshme hidrike, nga grafiku vihen re tempet e larta të rritjes së prodhimit nga HEC-et e dhënë me koncension mbas vitit 2008 si dhe nje hop i konsiderueshem ne vitin 2012.




Figure 12 Ecuria e Prodimit nga HEC-et e vegjël të dhënë me koncension dhe private

(Burimi ERE)

7.4 Importi i energjise elektrike

Në zbatim të kërkesave të Modelit Shqiptar të Tregut, importet e energjisë elektrike për nevoja publike në vendin tonë, kryhen nga furnizuesi publik me shumicë (FPSH) në përbërje të KESH-it, CEZ Shpërndarje sh.a dhe Furnizuesit e Kualifikuar. Ndërsa FPSH importon energji për të plotësuar nevojat e klientëve tariforë, CEZ importon energji elektrike për të mbuluar humbjet e energjisë elektrike në sistemin e shpërndarjes dhe Furnizuesit të Kualifikuar për nevojat e Klientëve të Kualifikuar.

Table 1 Importi i Energjise nga KESH Dhe CEZ gjate vitit 2012

| | Janar | Shkurt | Mars | Prill | Maj | Qershor | Korrik | Gusht | Shtator | Tetor | Neutor | Dhjetor | Tot 2012 |
|-----------------------------|---------|---------|---------|---------|---------|---------|--------|---------|---------|---------|---------|---------|-----------|
| Importi i Humbjeve nga OSSH | 111,600 | 278,400 | 370,037 | 237,600 | 166,320 | 151,200 | 79,512 | 186,929 | 53,194 | 22,396 | 0 | 0 | 1,657,688 |
| Import nga KESH | 192,000 | 46,984 | 0 | 23,376 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 243,662 | 224,885 | 149,838 | 880,745 |

Sasia e energjise se importuar apo blere me cmime tregu nga CEZ Shperndarje eshte me e vogel se energjia e deklaruar si humbje ne rrjetin e shperndarjes.

Sasia e energjise se importuar apo blere me cmime tregu nga ana e KESH eshte realizuar per te siguruar detyrimin per mos mungesen e energjise ne rrjet per konsumatorët tarifore.

Në grafikun e figurës -13- është paraqitur ballanca import-eksport e energjisë elektrike për periudhën 1985 – 2012. Sikurse vihet re deri në vitin 1998, (me përjashtim vetëm të vitit 1990) vendi ynë ka qenë një vend eksportues neto i energjisë elektrike. Sic shihet edhe për vitin 2012 vendi ynë rezultoi një importues neto. Sqarojme se vlerat e paraqitura perfaqesojne te gjitha flukset hyrese e dalese nga te gjithë aktoret e tregut te energjise elektrike ne Shqiperi.




Figure 13 Balanca Imp/Eksp e nergjise elektrike ne vite

Në grafikun e figurës -14- është paraqitur ecuria e importeve të energjisë elektrike gjatë periudhës 2002 deri 2012.




Figure 14 Ecuria e sasise se Importit të Energjisë Elektrike 2002-2012

(Burimi KESH, CEZ Shpërndarje)


Duke parë bilancet e importeve të energjisë elektrike, mund të thuhet me të drejtë se energjia elektrike përfaqëson një produkt me kosto shumë të lartë që për pasojë duhet të përdoret me eficiencë.

7.5 Humbjet e energjise elektrike

Një nga problemet më të rëndësishme, i cili në mënyrë kronike ndikon në uljen e eficientës së përdorimit të energjisë elektrike, në rritjen e pamotivuar të kërkesës për energji elektrike, si dhe në rritjen e çmimeve dhe tarifave të energjisë elektrike, mbetet problemi i humbjeve të energjisë elektrike, të cilat prej vitesh janë shumë më të mëdha, se ato që evidentohen në sistemet normale elektroenergjetike të vendeve të zhvilluara.

Sqarojmë se humbjet nga viti 2010 deri në vitin 2012 kanë ardhur në rritje si pasojë e keqmenaxhimit të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes (OSSH sh.a) nga shoqëria çeke CEZ Shpërndarje sh.a., e cila zotëronte 76% të kapitaleve të kësaj shoqërie.

Më poshtë jepet ecuria e konsumit total të energjisë elektrike dhe e nivelit të humbjeve nga viti 2002 deri në vitin 2012:



Grafiku. 15: Humbjet në sistemin elektroenergjetik (GWh) (Burimi: KESH)

Humbjet e energjisë elektrike, përfshirë ato teknike dhe jo teknike, përfaqësojnë sfidën më të vështirë dhe me efektin më të rëndë dëmtues në veprimtarinë ekonomiko-financiare të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes (OSSH). Ato dëshmojnë njëkohësisht edhe për punën e madhe, që ende duhet të bëhet, në mënyrë që ky problem të gjejë zgjidhjen e duhur.

Konsumi i energjisë elektrike, sidomos në nivelet e tensionit të ulët, shoqërohet me humbje shumë të mëdha teknike në rrjetin e shpërndarjes, për shkak të mbingarkesës dhe të rrjetit të amortizuar. Sasia e energjisë elektrike, që merret para matësit apo që nuk faturohet, që shkaktojnë të ashtuquajturat humbje joteknike, vlerësohet të jetë në një nivel të lartë, krahasuar me konsumin faktik.

Per vitin 2012 , niveli i humbjeve në sistemin e shperndarjes ka qënë në nivelin e 46.38 % ndersa në sistemin e transmetimit humbjet e energjisë elektrike ka qënë në vleftën 169.4 GWh ose 2.21%.

7.6 Tarifat e Energjise Elektrike

Nga analizat e treguesve tekniko-ekonomike te realizuar per 11 mujorin e viti 2012 si dhe parashikimin e pritshem te muajit Dhjetor 2012, u mundesua krahasimi i te ardhurave te miratuara nga ERE per vitin 2012 me ato qe priten te realizohen ne fakt, ne perputhje kjo me parimet e vendosjes se tarifave ashtu sic shprehen ne Metodologjine e Llogaritjes se Tarifave per Prodhuesin Publik si dhe ne Deklaraten Rregullatore.

Ne perfundim te perditesimeve te komponenteve te OPEX dhe te CAPEX u verejt se te ardhurat e rillogaritura per vitin 2012 per Kompanine Publike te Prodhimit rezultonin 2,360 milion leke nga 3,957 milion leke te miratura nga ERE ne 7.12.2011. Keto diferenca te te ardhurave ne fakt krahasuar me ato te miratuar ne avance per vitin 2012 vinin për shkak të saktësimit të shpenzimeve operative të shoqerisë si dhe te korrigjimit te vleres se bazes se rregulluar te aseteteve per vitin 2012, si rezultat i moszbatimit me korrektesi nga ana e kompanise te metodologjise perkatese. Ky korrigjim u shoqerua edhe me zbatimin e vleres me te ulet te pritshme te investimeve te shoqerise per vitin 2012 si dhe saktesimit te kostove te borxhit midis FPSH dhe KESH Gen.

Ne perfundim, keto te ardhura reflektojne per vitin 2012, nje tarife prej 0.61 leke/kWh nga 1 leke/kWh te miratuar ndersa per vitet 2013-2014,duke reflektuar perditesimin e viti 2012 si dhe ndryshimet ne llogaritjen e CAPEX do te rezultonte nje tarife mesatare prej 1.08 leke/kWh nga 1 leke/kWh te miratuar me vendimin e Bordit te Komisionereve nr 144 date 7.12.2011

Table 2 Parashikimet e bera nga ERE mbi te ardhurat e kërkuara per periudhen 2012-2014

| Zeri | Miratuar nga ERE per vitin 2011 | Rishikimi i vitit 2011 | 2012 | 2012 axhus | 2013 | 2014 |
|--|---------------------------------|------------------------|---------------|--------------|----------------|----------------|
| Blere energji nga Prodhuesi Publik | 4,046 | 3748 | 3,611 | 3,622 | 3,605 | 3,597 |
| Cmimi I prodhimit te energjise elektrike -leke/kWh | 0.63 | 0.63 | 1.0 | 0.61 | 0.83 | 1.34 |
| Kosto Totale e Prodhimit Publik-(000 leke) | 2,541 | 2,361 | 3,724 | 2,221 | 2,983 | 4,826 |
| Imortet e Energjise -GWh | - | 681 | 0 | 0 | 0 | 194 |
| Kosto e Importit - leke/kWh | - | 8.46 | 8.02 | 9.02 | 8.02 | 8.06 |
| Kosto totale e importit | - | 5761 | 0 | 0 | 0 | 1,564 |
| Blerje energjie nga PVE- GWh | 165 | 127 | 228 | 241 | 270 | 280 |
| Cmimi I PVE - leke/kWh | 7.10 | 7.37 | 8.10 | 8.58 | 8.30 | 8.20 |
| Kosto Totale e PVE- 000 leke | 1,172 | 936 | 1,847 | 2,068 | 2,241 | 2,296 |
| Blerje energjise nga TEC-Vlore-GWh | 24 | 51 | 72 | 0 | 0 | 0 |
| kosto e TEC-Vlore leke/kWh | 16.00 | 16.00 | 21.41 | 0.00 | | |
| Kosto Totale e TEC -Vlore- 000 leke | 384 | 816 | 1,541 | 0 | 0 | 0 |
| Blerje energjie nga IPP ndare | | | 200 | 352 | 363 | 363 |
| Cmimi I PVE - leke/kWh | | | 3.14 | 2.80 | 2.80 | 2.80 |
| Kosto Totale e PVE- 000 leke | - | - | 628.0 | 985.6 | 1,016.4 | 1,016.4 |
| Kosto Totale e Energjise -000leke | 4,097 | 9,874 | 7,740 | 5,274 | 6,241 | 9,702 |
| Shpenzime per personelin | 32 | 32 | 31 | 31 | 31 | 32 |
| Materiale | 2 | 2 | 2 | 2 | 2 | 2 |
| Furnitura e Sherbime | 8 | 8 | 8 | 8 | 9 | 9 |
| Shpenzime per interesa | 772 | 862 | 848 | 848 | 848 | 848 |
| Kosto fikse TEC-Vlore | 1,341 | 1,341 | 1,409 | | | |
| Totali I te Ardhurave te Kerkuara | 6,252 | 12,119 | 10,038 | 6,163 | 7,130 | 10,593 |
| Marzhi i Fitimit ((0.5% e te ardhurave te kerkuara per blerjen e energjise) | 27 | 56 | 46 | 26 | 31 | 49 |
| Kompensim per rillogaritjen e te ardhurave te FPSH per vitin 2011 | | | 5,200 | 5,360 | | |
| kompesim i te ardhurave nga eksporti I 2012 | | | -2,050 | -3,461 | -487 | |
| Rillogaritje/kompesim ie te ardhurave nga TEC vlore axhustimi I viti 2012 | | | -1,541 | | -27 | |
| Totali I te Ardhurave te Kerkuara-000 leke | 6,279 | 12,176 | 11,693 | 8,088 | 6,647 | 10,642 |
| Energji e shitur | 4,235 | 4597 | 4,111 | 3,689 | 4,164 | 4,434 |
| Tarifa e FPSH-se (leke/kWh) | 1.48 | 2.65 | 2.84 | 2.19 | 1.60 | 2.40 |

7.7 Humbjet nga Transformimi dhe Eficenca e Sistemit Energjetik Shqiptar

Ne total, humbjet nga procesi i transformimit te burimeve energjetike primare, vleresohen ne vlerat 5.01 ktoe ose 0.66% te TPP-se, dhe respektivisht humbjet ne procesin e transformimit per burimin energjetik te naftes kane qene ne vlerat 5.5 ktoe dhe per energjine elektrike 0.4 ktoe.

8. QYMYRI

Konsumi i qymyrit per vitin 2012 ka patur nje rritje per shkak te kerkeses se larte te konsumatorit industrial me 81.85 ktoe dhe me nje prodhim vendas te ulet deri ne 1.56 Ktoe. Vlen te theksojme se deri ne vitin 2008 ne Shqiperi konsumi i qymyrit ka qene i ulet, me pas shume konsumatore industrial filluan te importojne qymyr nisur nga levedishmeria ekonomike si dhe kerkesat e ulta te vendit tone ne lidhje me problemet ambjentale te tij.

Qymyret e vendit tonë kanë fuqi kalorifike që varion nga 2000 kkal/kg në 3000 kkal/kg dhe nxirren nga një thellësi që shkon deri në 300m, me trashësi shtrese 0.7-1m. Rezervat e parashikuara të qymyrit janë 794 milionë ton. Ato përqëndrohen kryesisht në zonën e Tiranës, me rreth 86% të rezervave, në zonën e Korçë-Pogradecit me 10% dhe në zonën e Memaliajt me 4%.

Përdorimi i qymyrit të vendit në të ardhmen e afërt nuk është parashikuar, për arsye të kostos së lartë të përfuturit të tij dhe të karakteristikave fiziko-kimike jo të favorshme. Sidoqoftë, nisur nga rezervat e limituara të hidrokarbureve në botë, opsioni i përdorimit të qymyrit të importit, për nevojat energjetike është lënë i hapur. Natyrisht, që përdorimi i tij do të bëhet duke respektuar rregulla të forta mjedisore të impianteve, që do të përdorin këtë lëndë energjetike.

9. DRUTE E ZJARRIT

Drute e zjarrit jane nje burim i rendesishem energjie, te cilet ka dhene dhe vazhdon te japin kontribut te ndjeshem ne bilancin energjetik shqiptar, ne plotesimin e nevojave per ngrohje, uje te ngrohte dhe gatim.

Ne vitin 2012, rezulton qe 90% e druve te zjarrit jane konsumuar ne sektorin e banesave dhe vetem nje pjese e vogel ne sektorin e sherbimeve dhe te industrise. Krahasuar me periudhen e viteve te kaluara, vihet re qe struktura e konsumit te druve te zjarrit sipas sektoreve ka ruajtur te njejtin tipar, ate te perdorimit te tyre ne sektorin e banesave.

Konsumi i druve te zjarrit edhe ne vitin 2012 (e llogaritur) konsiderohet te jete ne nivelin 206 ktoe.

10. KONSUMI I BURIMEVE ENERGETIKE NE INDUSTRIE NXJERRESE DHE PERPUNUESE TE NAFTES

Totali i vleresuar i burimeve energjetike te konsumuara ne deget e industrise nxjerrrese dhe perpunuese ka qene ne vleren 64.03 ktoe, respektivisht: 31 ktoe ne industrine e naftes sidomos ne deget e industrise nxjerrrese dhe perpunuese dhe 33 ktoe ne sektorin e rafinerise.


11. KONSUMI I BURIMEVE ENERGETIKE

Nga një vështrim i përgjithshëm i furnizimit gjithsej me burime energjetike primare, nga viti 1990 e deri në ditët e sotme, vërejmë se furnizimi për të gjithë sektorët ka pësuar një rritje nga viti në vit. Përfundimisht në këtë ecuri ka patur periudha 1990 -1992, në të cilën rënia e furnizimit me energji arriti nga 2.26 Mtoe në vitin 1990, në 1.22 Mtoe në 1992, si pasojë e mbylljes së aktiviteteve të shumë konsumatorëve industriale.

Më pas, situata e furnizimit me burime primare energjetike ka ardhur duke u përmirësuar për të arritur në vlerën 2014.15 Ktoe për vitin 2012.

Lidhur me konsumin final të burimeve energjetike, në grafikun 1 vërejmë se konsumi, sipas sektorëve të ekonomisë, nga viti 1999 deri në vitin 2012 ka pësuar ndryshime jo të mëdha. Konsumi final i burimeve në vitin 2012 ka qenë në vlerën 1847.86 ktoe. Në vitin 2012 kemi një ulje të konsumit total të energjisë me 1%, krahasuar me vitin 2011, si pasojë e reduktimit të konsumit në sektorin e industrise dhe transportit, të cilat janë të ndërruar nga problemet ekonomike që po kalon rajoni ynë.

Spektori i transportit mban peshën më të madhe përkundrejt totalit të konsumit të energjisë me 40.6 %, sektori i banesave 27.6 %, industria 17.1 %, sektori i shërbimeve 8.8 % dhe bujqësia e të tjerat 6.0 %.




Grafiku. 15: Konsumi final i burimeve energetike sipas çdo sektori [ktoe] (Burimi: AKBN)

Konsumi final i energjisë elektrike sipas sektorëve të ekonomisë është paraqitur në grafikun 2. Në vitin 2012 sektori i banesave ka konsumuar 53 % të energjisë elektrike. Pas tij vjen sektori i shërbimeve me 23 %, më pas sektori i industrisë me 20.7 %, dhe në fund vjen sektori i bujqësisë me 1 %. Vlen të theksojmë, se pas vitit 2008 KESH-i, nëpërmjet një harmonizimi të kënaqshëm të importeve gjithvjetore të energjisë elektrike, si dhe me përpunimin racional të rezervës hidroenergetike në kaskadë, arriti të kryejë furnizimin e plotë të konsumatorëve të vendit tonë me energji elektrike.


Në sektorin hidrokarbur për periudhën 2007-2012 vërehet një rritje e ndjeshme e prodhimit vendas të naftës brut, duke arritur në vitin 2012 në 1 030 723 ton (nga rreth 320 000 ton, që ka qënë në vitin 2000), ndërkohë që përpunimi i naftës brut në rafineritë e vendit ka pësuar rënie, si në vlerë absolute, por për më tepër në vlerë relative, në krahasim me prodhimin e naftës brut në vend, duke bërë që të rritet gjithmonë e më tepër eksporti i naftës brut.

Në grafikun 3, paraqitet konsumi final i produkteve të naftës, ndarë sipas sektorëve të ekonomisë, për periudhën 1999-2012, ku vërejmë një rritje të konsumit të naftës në sektorët e transportit, të shërbimeve dhe të industrisë.

Produktet e naftës e kanë ulur kontributin e tyre në konsumin final të energjisë nga 57.2% në vitin 1999 në 40.6 % në vitin 2012. Ulja e kontributit të tyre ka ndodhur për shkak se sektori i industrisë por rit përdorimin e qymyrit duke vëzvesuar produktet e naftës.



Grafiku. 16: Konsumi final i energjisë elektrike sipas çdo sektori [ktoe] (Burimi: AKBN)



Grafiku. 17: Konsumi final i produkteve të naftës sipas sektorëve [ktoe] (Burimi: AKBN)

Bazuar në bilancin energjetik të vitit 2012, rezulton, që sektori i transportit ka konsumuar rreth 72.7 % të produkteve të naftës, sektori i industrisë 11.2 %, sektori i bujqësisë përfshirë dhe peshkimin ka konsumuar 7.6 %, shërbimet 1.1 % dhe sektori i banesave ka konsumuar 7.1 % të produkteve të naftës.


13. ANALIZA E BURIMEVE ENERGETIKE NE KONSUMIN FINAL SIPAS DEGEVE

13.1 Produktet e naftes

Vleresimet e bera per vitin 2012 tregojne se konsumi i produkteve hidrokarbure ka pesuar nje ulje rreth 11% ne vit, krahasuar me vitin 2011. Ritmi kesaj rritjeje ndodh si pasoje e ndikimit te situates ekonomike ne ekonomine e vendit tone.


Per vitin 2012, konsumi i produkteve te naftes rezulton te jete 1012.9 ktoe, ku ne kete sasi rreth 89.5% mbulohet nga produktet e importuara. Duke analizuar statistikat e produkteve hidrokarbure del qarte se importet jane rritur ne menyre te ndjeshme brenda 6 viteve te fundit dhe kjo parashikohet te vazhdoje edhe ne te ardhmen si pasoje e rritjes se zhvillimit ekonomik te vendit.

Duke iu referuar sektoreve ekonomik per konsumin e produkteve te naftes, transporti ze vendin kryesor me 67.9% te totalit te konsumit final, industria me 14.1%, bujqesia me 7.4%, banesat me 7.5% sherbimet 3.1%. (figura 18).



Grafiku 18: Konsumi Final i Naftes & Nenprodukteve/ sektoreve ekonomike neVitin 2012. [%]Burimi AKBN

Krahasuar me bilancin e vitit 2011 ne vitin 2012 konsumi i produkteve te naftes ne sektorin e industrise ka nje ulje me 71.25 ktoe si pasoje e perdorimit te qymyrit ne kete sektor i cili konkuron me cmim me te ulet se produktet e naftes. Sektori i transportit ulet me 30.27 ktoe, si pasoje e situates ekonomike ku konsumatori privat e ka ulur kete konsum. Sektori i banesave dhe i sherbimeve ka patur nje ulje te konsumit si pasoje e perdorimit te energjise elektrike dhe druve te zjarrit. Ndersa bujqesia ka nje rritje rreth 1.12 ktoe si pasoje e kekeses se larte ne tregun e produkteve bujqesore. (Grafiku 19)



Grafiku 19: Konsumi Final i Energjise produkteve te naftes ne deget e ekonomise 1999-2012 [ktoe]

Burimi: AKBN

Diezeli rezulton si karburanti kryesor ne bilancin e produkteve te naftes ne Shqiperi me rreth 68% te konsumit dhe me pas vjen benzina me 10.5%.

Analizat e detajuara te ecurise se konsumit te produkteve te ndryshme te naftes per vitin 2012 tregojne se gazi i lengshem i naftes ka patur nje ulje 12.62 ktoe krahasuar me vitin 2011, si pasoje e rritjes se perdorimit te energjise elektrike. Sidoqofte parashikimet e sektorit te energjise tregojne se LPG do te vazhdoje te ritet, pasi kjo lende energjetike eshte zevendesuesja me e shpejte e energjise elektrike. Per vitin 2012 konsumi i gazit te lengshem ka qene ne nivelin 88.38 ktoe, (theksojme qe te dhenat mbi konsumin e produkteve te naftes jane bazuar mbi te dhena zyrtare dhe vleresime nga AKBN-ja).


13.2 Konsumi i Energjise Elektrike sipas degeve te ekonomise

Ne vendin tone konsumi familjar ndaj konsumit te pergjithshem te faturuar edhe per vitin 2012 perben 53%, çka tregon nje ekonomi me zhvillim industrial te kufizuar. Sektori i dyte ne konsumin e energjise elektrike eshte sektori industrial dhe ai i sherbimeve. Duke qene keshtu, ritmet e larta te zhvillimit ekonomik te vendit do te ndikojne edhe ne rritjen e ritmeve te kerkese per energji.

Ne vendin tone vazhdon perdorimi i energjise elektrike per ngrohje perben nje dukuri tjeter problematike te konsumit te energjise elektrike ne vendin tone. Çdo ndryshim i temperatures se mjedisit reflektohet menjehere ne konsumin ditor te energjise elektrike, pikerisht ne saje te efektit te perdorimit ose mosperdorimit te ngrohjes me energji elektrike te baneses.

Siç vihet re nga Grafiku 20, peshen me te madhe ne konsumin e energjise elektrike per vitin 2012, e mban sektori banesave me 53%, e me pas vijne sherbimet me 23%, industria 20.7 %, te tjera 1% dhe bujqesia me 2.4%.

Ne sektorin shtepiak eshte ruajtur e njejta strukure e konsumit te energjise elektrike, respektivisht; 29% e energjise elektrike te konsumuar eshte perdorur per ngrohje, rreth 22%, konsumohet per uje te ngrohje, rreth 25% per gatim etj.



Grafiku20: Konsumi final i energjise elektrike ne degjet e ekonomise.

Viti 2012 [%]Burimi: AKBN

Ne sektorin e industrise peshen me te madhe ne konsumin e energjise elektrike e mban Industria Ushqimore e Pijeve & Duhanit me 20%, me pas vijne degjet e industrise materialeve te ndertimit me 18%, e hekurit me 15%, etj.

Ne Sektorin e Sherbimeve vihet re e njejta strukture e konsumit te energjise elektrike, konkretisht: per gatim, kondicionim (ngrohje dhe freskim), ndricim, paisjet elektroshtepiake, etj. Sektori i Sherbimeve ze rreth 10% te totalit te konsumit final te burimeve energjetike dhe ne menyre specifike 23.6% te konsumit te energjise elektrike.

14. DRUTE E ZJARRIT DHE QYMYRI

Drute e zjarrit dhe qymyri nuk paraqesin ndryshime strukturore te perdorimit te tyre ne deget e ekonomise, megjithate veme ne dukje qe mungojne informacionet e sakta per furnizimin dhe konsumin me keto burime energjie.

15. KONSUMI I BURIMEVE TE RINOVUESHME

Nisur nga pozicioni gjeografik, me një klimë tipike mesdhetare, Shqipëria zotëron burime të konsiderueshme të energjive të rinovueshme. Këto burime mund të shfrytëzohen jo vetëm për zvogëlimin e kontributit të energjisë elektrike nga burimet konvencionale, por dhe për përfitimin e energjive të tjera të pastra.

Shqipëria ka ndërmarrë hapa të rëndësishëm, për të implementuar në politikat energjetike kombëtare të saj, kërkesat e Direktivave të Bashkimit European, përta i takon rregullave për krijimin dhe zhvillimin e tregut të brëndshëm të energjisë dhe promovimin e prodhimit dhe konsumit të energjisë nga burimet e rinovueshme të saj.

Direktiva për promovimin e prodhimit të energjisë nga burimet e rinovueshme është transpozuar në Ligjin e ri “Për burimet e rinovueshme”, miratuar në 2 Maj 2013, si dhe në Ligjin e aprovuar për Biokarburantet. Gjithashtu, Ministria e Ekonomise, Tregtisë dhe Energjetikës dhe Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore janë duke punuar për të përgatitur aktet nënligjore respektive.

Pas analizës së mekanizmave nxitës të mundshme dhe rishikimit të praktikave më të mira të kryera nga shtetet e tjera, anëtare të BE-se, në vendin tonë, që nga 19 Janari 2007, është adoptuar një sistem për tarifaf fikse (feed-in), në mënyrë të veçantë për HEC-et e vegjël, ekzistues dhe të rinj, i cili ofron një siguri më të madhe për investitorët dhe siç ka treguar eksperinca ka filluar të japë rezultatet e veta.

Sistemi i tarifave fikse (feed-in) krijon kushte për promovimin e energjisë elektrike të prodhuar nga burimet e rinovueshme. Duke theksuar se në ligjin e ri “Për burimet e rinovueshme”, niveli i këtyre tarifave ka marrë parasysh tipin, teknologjinë, si dhe efiçencën e paisjeve gjeneruese të energjisë.

Ligji për burimet e rinovueshme dhe Ligji për Biokarburantet, gjithashtu, ofrojnë incentiva të tjera si:

- përparësi për lidhjen me rrjetin e transmetimit dhe të shpërndarjes;

- pagesën vetëm të kostove direkte të lidhjes me rrjetin e transmetimit dhe të shpërndarjes së energjisë elektrike;
- marrëveshje shitblerjeje afatgjata (15 vjet për energjinë elektrike të prodhuar nga hidrocentralet me fuqi të instaluar deri në 15 MW)
- blerjen e detyrueshme të energjisë elektrike të prodhuar nga impjantet e burimeve të rinovueshme deri në 15 MW;
- Çmim më të mirë stimulues për ndërtimin e këtyre impjanteve.

Ligji i Biokarburanteve, gjithashtu, ka të përfshira incentiva për përdorimin e biokarburanteve në sektorin e transportit si më poshtë:

- përzierja e detyrueshme e biokarburanteve me naftën dhe derivatet e saj;
- reduktimi i normës së akcizës, për shkak të përzierjes së karburantit në një përqindje të caktuar;
- normë zero për akcizën e karburanteve që janë bio.

Si rezultat i këtyre masave, interesi për shfrytëzimin e burimeve të rinovueshme është rritur në mënyrë të ndjeshme dhe kanë filluar të ndërtohen, para së gjithash, hidrocentrale të rinj, si teknologji më e njohur dhe më e besueshme, e ndjekur nga sistemet e paneleve diellore për ujë të ngrohtë dhe për vendosjen e turbinave të prodhimit të energjisë elektrike nga energjia e erës. Në një shkallë më të ulët kanë filluar të kërkohen nga investitorët autorizime për ndërtimin e paneleve diellore për prodhimin e energjisë elektrike.

Në vitin 2011, në Zonën Energjetike dhe Industriale të Porto Romanos u vu në shfrytëzim impianti i prodhimit dhe bledingut të biokarburanteve, që është njëkohësisht edhe impianti i parë i këtij lloji në Shqipëri.

Nisur nga pozicioni gjeografik, me një klimë tipike mesdhetare, Shqipëria zotëron burime të konsiderueshme të energjive të rinovueshme. Këto burime mund të shfrytëzohen jo vetëm për zvogëlimin e kontributit të energjisë elektrike nga burimet konvencionale, por dhe për përfitimin e energjive të tjera të pastra.

Hidroenergja është burimi më i madh i energjive të rinovueshme në vendin tonë. Shqipëria renditet në Europë si një vend me pasuri ujore të konsiderueshme, me një shtrirje hidrografike të shpërndarë pothuajse në të gjithë territorin.

Shqipëria, me sipërfaqen e saj prej 28 748 km², ka një shpërndarje hidrografike me një sipërfaqe ujëmbledhëse prej rreth 44,000 km² ose 57% më shumë se territori shtetëror. Nga

pikpamja topografike, duke qenë një vend me relief relativisht të thyer, vendi ynë ka një rezervë hidroenergjitike të madhe.

Nëpërmjet një politike koncensionare konkurruese e transparente dhe të mbështetur në një kuader të plotë ligjor dhe nënligjor, u bë e mundur që të nënshkruhen dhe miratohen nga Qeveria, 127 kontrata koncensionare, për ndertimin e HEC-eve me fuqi të vogël, të mesme dhe të madhe, me investitorë vendas dhe të huaj, prej të cilëve pritet, që të futet në shfrytëzim një potencial gjenerues hidroelektrik prej rreth 1740 MW, që parashikohet të prodhojë një sasi energjie elektrike nga burime të rinovueshme prej rreth 4 miliarde kWh në vit.

Territori i Shqipërisë është i vendosur në pjesën perëndimore të Ballkanit dhe ka një potencial të lartë të **energjisë diellore**. Numëri i ditëve me diell në vendin tonë luhet nga 240 – 260 ditë, me një maksimum prej 280 ditë. Megjithatë kontributi i kësaj energjie, përkundrajt totalit të burimeve energjetike, është jo më shumë se 0.1%. Kryesisht energjia diellore shfrytëzohet për prodhimin e ujit të ngrohtë sanitar dhe një pjesë fare e vogël e kësaj energjie shfrytëzohet me panele fotovoltaike. Bazuar në të dhënat e vitit 2012, penetrimi i paneleve për ujë të ngrohtë është 23.5 m²/1000 banor

Për këtë arsye, në strategjinë kombëtare të energjisë, shtimi i përdorimit të paneleve diellore është prioritet i qeverisë dhe në këtë kuadër po punohet me një projekt 5 vjeçar në bashkëpunim me PNUD-in.

Shfrytëzimi i **energjisë së erës** në vendin tonë akoma nuk ka filluar, por ka një shprehje shumë të madhe interesi nga investitorët e huaj. Në këtë kuadër, janë në studim disa rajone të vendit tonë nga disa kompani të huaja. Deri në fund të vitit 2012, nga Ministria e Ekonomisë Tregtisë dhe Energjetikës, si dhe nga ERE janë licensuar 15 kompani, për të ndërtuar parqe me erë, me një fuqi të instaluar prej rreth 1 600 MW, të cilat shtrihen kryesisht në zonën bregdetare të vendit, duke filluar nga qarku i Lezhës në veri e deri në rajonin e Sarandës në jug.

Biomasa në vendin tonë vlerësohet si burim energjie dhe është ngushtësisht e lidhur me drutë e zjarrit. Në vitin 2012, rezulton që 93% e druve të zjarrit të përdorura, janë konsumuar për ngrohje dhe gatim dhe vetëm 7% është përdorur në shërbime të tjera. Biomasa kontribuon nëpërmjet druve të zjarrit në bilancin energjetik të vendit me 10 %. Në mbështetje të shrytëzimit të biomasës në vitin 2008 është dhënë licenca për ndërtim, instalim dhe për prodhimin e energjisë elektrike nga një TEC me fuqi të instaluar prej 140 MW.

| | TOTAL | Solid fuels | Natural Gas | Crude, NGL and Feedstock | Biomass (Fuelwood) | Hydro & Electricity | Solar Energy | Derived Heat |
|--|----------------|--------------|-------------|--------------------------|--------------------|---------------------|--------------|--------------|
| Year 2012 | | | | | | | | |
| Primary production | 1676.30 | 1.56 | 14.7 | 1030.723 | 206.5 | 406.35 | 11.80 | 4.7 |
| Recovered products | 0.00 | | | 0.0 | | | | |
| Imports (Pet Prod+ Electricity) | 1277.44 | 81.85 | | 977.32 | | 218.27 | | |
| Stock change | 29.50 | | | 29.50 | | | | |
| Exports | 957.29 | 0.2 | | 957.09 | | 0.00 | | |
| Bunkers | 12.00 | | | 12.00 | | | | |
| Gross inland consumption | 2014.15 | 83.41 | 14.7 | 1068.46 | 206.50 | 624.62 | 11.80 | 4.70 |
| Transformation input | 517.00 | | | 110.65 | | 406.35 | | |
| Classic thermal Power Stations | 0.00 | | | 0 | | 0 | | |
| Public Hydro power stations | 402.85 | | | | | 402.85 | | |
| Autoprod. thermal power stations | 0.40 | | | 0.00 | | 0.4 | | |
| Nuclear power stations | 0.00 | | | | | | | |
| Patent fuel and briquetting plants | 0.00 | | | | | | | |
| Coke-oven plants | 0.00 | | | | | | | |
| Blast-furnace plants | 0.00 | | | | | | | |
| Gas works | 0.00 | | | | | | | |
| Refineries | 110.65 | | | 110.65 | | | | |
| District heating plants | 0.00 | | | | | | | |
| Transformation output | 663.20 | 0 | 0 | 106.15 | | 405.95 | | 1.5 |
| Classic thermal Power Stations | 0.00 | | | | | 0.00 | | |
| Public Hydro power stations | 405.95 | | | | | 405.95 | | |
| Autoprod. thermal power stations | 0.00 | | | | | | | |
| Nuclear power stations | 0.00 | | | | | | | |
| Patent fuel and briquetting plants | 0.00 | | | | | | | |
| Coke-oven plants | 0.00 | | | | | | | |
| Blast-furnace plants | 0.00 | | | | | | | |
| Gas works | 0.00 | | | | | | | |
| Refineries | 107.45 | | | 106.15 | | | | 1.3 |
| District heating plants | 0.00 | 0 | | | | | | |
| Exchanges and transfers, returns | 0.00 | | | | | | | |
| Interproduct transfers | 0.00 | | | | | | | |
| Products transferred | 0.00 | | | | | | | |
| Returns from petrochem. industry | 0.00 | | | | | | | |
| Transformation Losses | 5.10 | 0 | 0 | 4.50 | | 0.40 | | 0.2 |
| Consumption of the energy branch | 64.03 | | 11.0 | 20.00 | | 33.03 | | 0 |
| Production and distribution of electricity | 0.33 | | | | | 0.33 | | |
| Pumped storage stations | 0.00 | | | | | | | |
| District heating plants | 0.00 | | | | | | | |
| Extraction and aggl. of solid fuels | 0.00 | | | | | | | |
| Coke-oven and gas works plants | 0.00 | | | | | | | |
| Oil and Nat. Gas extraction plants | 49.96 | | 9.5 | 17.00 | | 23.50 | | |
| Oil & Gas pipelines | 0.00 | | | | | | | |
| Oil refineries | 13.70 | | 1.5 | 3 | | 9.2 | | |
| Nuclear fuel fabrication plants | 0.00 | | | | | | | |
| Distribution losses (humbje jo tekn ne shpernd) | 95.86 | | | | | 95.86 | | 0.00 |
| Available for final consumption | 1847.86 | 83.41 | 3.7 | 1043.96 | 206.50 | 495.33 | 11.80 | 3.20 |
| Final non-energy consumption | 31.04 | | | 31.04 | | | | |
| Chemical industry | 1.03 | | | 1.03 | | | | |
| Other sectors | 21.01 | | | 21.01 | | | | |
| Final energy consumption | 1816.83 | 83.4 | 3.7 | 1012.9 | 206.5 | 495.33 | 11.8 | 3.2 |
| Industry | 310.72 | 77.71 | 3.7 | 113.21 | 10 | 102.50 | 0.40 | 3.2 |
| Iron & steel industry | 22.18 | | | 9.02 | | 13.16 | | |
| Non-ferrous metal industry | 5.05 | | | 0.05 | | 5.01 | | |
| Chemical industry | 17.96 | | | 9.80 | | 8.15 | | |
| Glass, pottery & building mat. industry | 144.87 | 77.71 | | 51.17 | | 15.98 | | |
| Ore-extraction industry | 6.23 | | | 0.49 | | 5.74 | | |
| Food, drink & tobacco industry | 49.42 | | 2.7 | 23.06 | | 20.06 | 0.40 | 3.2 |
| Textile, leather & clothing industry | 14.23 | | | 1.13 | | 13.11 | | |
| Paper and printing | 9.22 | | | 1.00 | | 8.22 | | |
| Engineering & other metal industry | 6.57 | | | 1.70 | | 4.88 | | |
| Other industries | 35.01 | | 1.00 | 15.83 | 10 | 8.18 | | |
| Transport | 736.73 | | | 736.73 | | | | |
| Railways | 2.70 | | | 2.70 | | | | |
| Road transport | 696.43 | | | 696.43 | | | | |
| Air transport | 19.60 | | | 19.60 | | | | |
| Inland navigation | 18.00 | | | 18.00 | | | | |
| Households, commerce, pub. auth., etc. | 660.80 | 5.2 | | 83.18 | 184.5 | 376.52 | 11.40 | |
| Households | 500.58 | 0.5 | | 72.20 | 160 | 262.50 | 5.38 | |
| Agriculture | 81.21 | | | 57.21 | 12 | 12.00 | | |
| Fisheries | 22.00 | | | 22.00 | | | | |
| Other | 5.00 | | | 0.00 | | 5.00 | | |
| Statistical difference | | | | 0.00 | | | 0 | 0 |